

Pa dëgjo fyellin ç'thotë
Tregon mërgimet e shkreta,
Qahet nga e zeza botë
Me fjalë të vërteta.

Që kur se më kanë ndarë
Nga shok' e nga miqësija,
Gra e burra kanë qarë
Nga ngashërimet e mija!

Krahërore e kam çpuar
E kam bërë vrima vrima,
Dhe kam qar' e kam rënkuar
Me mijëra psherëtima!

Dhe me botën e gëzuar
Bëhem shok edhe marr pjesë,
Dhe me njerës të helmuar
Bënem mik me besa-besë.

Puna si do që të bjerë
Unë qanj me mallëngjime,
Më çdo vënt e kur-do-herë
Psherëtin zëmëra ime!

Gjithë bota më dëgjojnë
Po së jashtëmi më shohin,
Dëshirën s'm'a kupëtojnë
Zjar' e brendëshme s'm'a njohim.

Njerëzit me mua rrinë,
Unë qanj' e mallëngjehem,
Po dufn' e pshehtë s'm'a dinë
Andaj kurrë s'përdëllehem.

Gjith' ata që janë ndarë
Fyellit shokë ju bënë,
Shkallët' e tij disa farë,
Na shkalluan mëndjen tënë.

Rrëmet i njerëzisë!
Zër' i fyellit s'është' erë,
Ky është' zjarr' i dashurisë
Që i ra kallamit mjerë!

I ra qiellit e ndriti,
I ra zëmrësë e nxehu,
I ra verës e buçiti,
I ra shpirtit, dhe e dehu.

I dha erë trëndafililit
I dha dritë bukurisë,
I dha këngëtë bilbilit,
I dha shije gjithësisë.

Ay zjar i ra në qiej,
Edhe duke përvëlur,
U bënë kaq yj e diej,
Që i mba Zoti ndër duar,

Nga ky zjar Zot' i vërtetë,
Që ka ngehur gjithësinë,
Hoth një shkëndijë në jetë,
Dhe bëri soje njerinë.

More zjar i bekuar!
Unë me ty jam përzjerë,
Pa jam tretur e kulluar,
Po të kam shpirt, mos më lerë.

Po japim më poshtë tekstin e vjershës së famshme të Rumiut në një përkthim të lirë të prof. Jorgo Bulos:

Kënga e kal I amit

Dëgjoje fyellin si tregon historinë e tij, si vajton i trishtuar për ndarjen:

"Qëkurse më ndanë nga kallamishtja, tingulli im i ëmbël i ka bërë
të qajnë burra e gra!

Një zemër dua, një zemër të copëtuar nga ndarja e Mikut, që mund
t'i shpjegojë pasionin e mallit të dashurisë.

Se kushdo mbetet larg nga origjina e vet, përherë kërkon kohën kur ishte bashkuar me të!

Unë në çdo tubim kam vajtuar me notat e mia rënkuese,

shok gjithnjë me fatkeqtë dhe me të lumturit,

dhe të gjithë patën iluzionin sikur ishin miqtë e mi, dhe askush
nuk kërkon në zemrën time të fshehtë të time më të thellë.

Por e fshehta ime nuk është larg, jo, nga rënkimi im: janë sytë
dhe veshët që s'e kanë atë Dritë!

Nuk e vesh trupin shpirti, nuk e vesh shpirti trupin: megjithatë
shpirtin s'e sheh dot njeri".

Zjarr është kjo klithmë e fyellit, jo erë, dhe ai që s'e ka këtë
zjarr e meriton të tretet në hiç!

Është zjarri i dashurisë që i ka rënë fyellit, është flaka
e dashurisë që e ndezi verën.

Fyelli është shok besnik i atij që e ndanë nga një mik; ende na
sëmbojnë zemrën meloditë e tij.

Kush ka parë ndonjëherë një kundërhelm dhe helm si fyelli?

Kush ka parë ndonjëherë një shok të besës e një dashnor si

fyelli? Fyelli na tregon për një shteg të skuqur i tëri nga gjaku, na
tregon edhe historitë e dashurisë së Maxhunit:

vetëm atij që është jashtë shqisave i besohet kjo shqisë, gjuha

s'ka myshterinj të tjerë veç veshit.

Ditët na shqetësonin me dhimbjen, ditën morën përdore mundime zjarri. Nëse ditët tona shkuan
thuj, "S'i kam frikë!" Po Ti, Ti mos shko,

Ti që je më i kulluari nga të gjithë!

Por gjendjen atij që është pjekur asnjë aguridh s'e kupton;

E shkurtër pra le të jetë fjala ime. Lamtumirë!